



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 28, datë 30.03.2026

PËR
MIRATIMIN E SHTYRJES SË AFATIT TË LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“RIKONSTRUKSION I NDËRTESESË NË PËRDORIM NGA FAKULTETI I
GJEOLGJISË DHE I MINIERAVE TË UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS
DHE NDËRTIMI I MUZEUT TË GJEOLGJISË”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË
TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues Universitetit Politeknik të Tiranës, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin e shtyrjes së afatit të Lejes së Ndërtimit të objektit: “Rikonstruksion i ndërtesës në përdorim nga Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave të Universitetit Politeknik të Tiranës dhe ndërtimi i Muzeut të Gjeologjisë”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, me subjekt zhvillues Universitetin Politeknik të Tiranës, miratuar me Vendimin Nr. 01, datë 28.09.2022 të Këshillit Kombëtar të Territorit (sot KKTU).
2. Afati i kryerjes së punimeve sipas këtij Vendimi, do të pasqyrohet në Dokumentin e Lejes së Ndërtimit, në përputhje me afatin e përcaktuar në grafikun e punimeve.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyjnë në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I ARSIMIT

MIRELA KUMBARO FURXHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 07/05 2026